REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/KOSOVA CUMHURIYETI
KOMUNA E GJILANIT - OŠTINA GNJILANE - GILAN BELEDYIE
02/016 Nr/Br/No 6847123
Data/Datum/Tarih 13-07/2023
GJILAN - GNJILANE - GILAN

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E GJILANIT
MUNICIPALITY OF GJILAN - OPŠTINA GNJILANE - GILAN BELEDIYESI

Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore

Datë: 13.07.2023, Gjilan

Në bazë të nenit 79 dhe 80, të Ligjit për Zyrtarët Publikë Nr. 06/L-114 dhe nenit 7 dhe 8 të Rregullores (QRK) Nr.05/2022 për Procedurat Konkurruese dhe Pranimi për Nëpunësit Administrativ dhe Mbështetës, Komuna e Gjilanit bën këtë;

## SHPALLJE PËR REKRUTIM

**Titulli i pozitë punuese:** Korrier/Ekspedues
**Institucioni:** Komuna Gjilanit
**Drejtoria:** Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë
**Kategoria funksionale:** Teknike mbështetëse
**Numri i pozitave:** (1) një
**Grada/Koeficienti:** 3.8
**Kohëzgjatja e marrëdhënies së punës:** në kohë të pa caktuar

### 1. Kërkesat e përgjithshme për pranimin e zyrtarëve publik:

1.1. të jetë shtetas i Republikës së Kosovës,
1.2. të ketë zotësi të plotë veprimi,
1.3. të zotëroj njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët,
1.4 të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse,
1.5. të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë,
1.6. të mos ketë në fuqi një masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik, të pushuar sipas LPZ.

Përveç kushteve të mësipërm cekura kandidati për tu pranuar në pozitën e nëpunësit teknik mbështetës duhet që me sukses të kaloj procedurat e pranimit sipas LZP.

**Detyrat dhe përgjegjësitë:**

**Detyrat kryesore:**

- Kryen punët e dërgimit të postës interne dhe të jashtme për nevojat e DGJKP si dhe për personat juridik dhe fizik;
- Bënë evidentimin në librin postar të flet dërgesave dhe flet kthimeve të postës;
- Dërgesat e pranuara nga posta para shpërndarjes i evidenton dhe protokollon në QSHQ;
- Informon Udhëheqësin e drejtpërdrejtë dhe Udhëheqësit e sektorëve në drejtori lidhur me postën e padorëzuar apo shkresat e pashpërndara me kohë, si dhe ndërmarrjen e veprimeve adekuate që shkresat-posta të shpërndahet;
- Me kërkesën e drejtorisë vendos njoftime në tabelën e shpalljeve komunale dhe DGJKP lidhur me aktivitetin e drejtorisë;
- Kryen edhe punë tjera sipas kërkesës së udhëheqësit të drejtpërdrejtë dhe udhëheqësve të sektorëve në kuadër të DGJKP.

**Shkathtësitë e kërkuara:**

- Shkathtësi të dëshmuar në komunikim me shkrim dhe gojë;
- I gatshëm të marr përgjegjësi dhe të punoj nën presion.

**Kushtet:**

- Shkollimi i mesëm;
- 1 vitë përvojë pune
- I preferuar patentë shoferi/jo obligativ

Çdo kandidat (aplikues) për pozitën e lartcekur duhet t'a kompletoj dhe dorëzoj dokumentacionin e domosdoshëm (fotokopje) si vijon:

1. Dëshmi të kualifikimit shkollorë, fotokopje e noterizuar
2. Dëshmi mbi përvojën e punës (Vërtetim i protokolluar dhe vulosur ose Kontrata e punës e protokolluar dhe vulosur)
3. Dokumentin e identifikimit
4. Certifikatën se nuk është nën hetime dhe nuk është i dënuar për ndonjë vepër penale
5. Certifikatën mjekësore **(Për shkak të minimizimit të shpenzimeve të kandidatëve pjesëmarrës në konkurs, në fund të procedurës rekrutuese e njëjta do të kërkohet vetëm nga kandidati fitues)**

**Komunitetet jo shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional siç specifikohet në LPZ**

**Konkursi mbetet i hapur 8 ditë nga data 28.07.2023 deri me 04.08.2023.**

**Paraqitja e kërkesave:** Aplikacionet merren dhe të plotësuara dorëzohen në arkivin qendror të Komunës së Gjilanit, përkatësisht në Qendrën për Shërbim me Qytetarë.

**Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen, kurse ato të mangëta refuzohen.**

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e shkurtër do të njoftohen për vendin, datën dhe kohen e mbajtjes së testimit, përmes Ueb faqes zyrtare të komunës dhe emajlit personal të aplikantit.

**Konkurimi për pranim përfshin dy (2) faza:** Verifikimin paraprak të aplikacioneve dhe Vlerësimin e kandidatëve e ku vlerësimi bëhet përmes jetëshkrimit (CV) dhe një interviste me gojë.

Aplikacionet e pranuara me dokumentacion përcjellës në fotokopje, nuk kthehen. Rezultatet shpallen në linkun: https://konkursi.rks-gov.net, ueb faqen komunale, tabelën e shpalljeve dhe njoftim të kandidatëve përmes emalit të shënuar në aplikacion.